



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. _____ Prot

Date 19 /01/2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data 19_/01/2024

Drejtuar: BESTA shpk NIPT J62903182B me adrese Berat Ura Vajguore Ura Vajguore Njësia Administrative Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20,

Procedura e prokurimit/lotit: **PROÇEDURË E HAPUR - pune**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF 91612-12-19-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Rehabilitim i nyjes se trafikut Mangalem**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: brenda 2 muajve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 103 datë 26 Dhjetor 2023 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **BESTA SHPK me Nipt J62903182B** Oferta e operatorit ekonomik 17 415 310 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqindë e pesëmbëdhjetë mijë e treqindë e dhjetë) lekë pa tvsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

2. **L.T.E CONSTRUCTION SHPK me Nipt L78006801F** Oferta e operatorit ekonomik 13 552 930 (trembëdhjetë milion e pesëqindë e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqindë e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

1. **L.T.E CONSTRUCTION SHPK me Nipt L78006801F**

Oferta e operatorit ekonomik 13 552 930 (trembëdhjetë milion e pesëqindë e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqindë e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe konformë kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të tenderit, konkretisht :

-Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2/c të DST-ve pasi nuk ka paraqitur licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të leshuar nga Ministria e Kulturës N_Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

-Sipas vetëdeklarimit të paraqitur për mjetin Buldozier, nuk është deklaruar afati i kontratës së qerasë sipas shtojcës 8.

-Sipas vetëdeklarimit të paraqitur për pajisjet Kutu e ndihmës së shpejtë dhe Tabela paralajmëruese për sigurinë, nuk është deklaruar sasia sipas kërkesave në DST, ndërsa për pajisjet këpucë nuk i ka deklaruar.

-Sipas vetëdeklarimit të paraqitur për punonjësën L.R është deklaruar me dy profesione, njëherë si hekurthyes dhe si asfaltoshtrues.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos s'kualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

* * *



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BESTA SHPK me Nipt J62903182B me adrese** Berat Ura Vajguore Ura Vajguore Njësia Administrative Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, me oferte ekonomike 17 415 310 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqindë e pesëmbëdhjetë mijë e treqindë e dhjetë) lekë pa tvsh. [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkia Berat , rruga Antipatrea]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7 diteve ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ervin DEMO

Konc: F.Arapi
Miratoi : P.Sinjari